



Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

PROCESVERBAL

Mbledhja e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale është mbajtur me datë **27.10.2023 (e premte)** me fillim në orën **08:35**.

Mbledhjen e dytë e kryesoi kryesuesja, znj. **Vlora Vuçiterna Çmega**.

Për këtë mbledhje, u propozua ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vizitë në QMF – Ratkoc;
3. Të ndryshme.

Kryesuesja: Fillimisht përshëndetje për të gjithë! Pas leximit të rendit të ditës, po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “pro”?... Me vota unanime miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesja: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “pro”?... Me shumicë unanime aprovohet pika e parë.

2. Vizitë në QMF – Ratkoc;

Kryesuesja: Atëherë, ne e kemi njoftuar Drejtorinë e Shëndetësisë për këtë vizitë që do ta realizojmë sot, nëse dikush ka diçka për të thënë?...

3. Të ndryshme.

Kryesuesja: Jemi te pika e fundit, nëse dikush ka diçka për të shtuar?

Lirigzon Kastrai – Përshëndetje të nderuar, propozoj që pasi të kthehemi nga vizita në QMF-në e Ratkocit, të ndalimi edhe në QMF-në e Fortesës, pra ta bëjmë edhe aty një vizitë. Vizitën në QMF-në në Fortesë nëse kemi kohë e propozova nëse jo atëherë mundemi me bë vizitën në një mbledhje tjetër.

Armir Vuçitërna – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar nuk e di se sa na premton koha sot që të shkojmë në vizitë në QMF-në e Ratkocit, siç e dini ne ora 10 e kemi mbledhjen e kuvendit, por nëse na premton koha nuk jam kundër.

Kryesuesja – Besoj se koha do na premton, ne gjithmonë para mbledhjes i kemi kryer këto vizita. A ka dikush të shtojë edhe diçka, nëse jo, atëherë konstatojmë që mbledhja përfundoi.

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

Kryesuesja e mbledhjes:



Vlora Vuçiterna - Çmega